



- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).

- Neni 7, pika 1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).

- Neni 7, pikat 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte).

- Me vendimin nr. 163, datë 28.12.2015, Bordi ERE-s, ka vendosur fillimin e procedurave për lënien peng. Gjatë hetimit nga ana e ERE-s është konstatuar se subjekti ka hyrë në marrëveshje me Bankën për të lënë asetet që disponon, si garanci hipotekore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HEC Tervoli” sh.p.k. për lënie si garanci hipotekore pranë Raiffeisen Bank, të asetëve që disponon, si më poshtë:

a) Gjeneratori elektrik, panele elektrike, turbina, nënstation elektrik;

b) Pasuri e paluajtshme, 1028 m<sup>2</sup> ndërtim, referuar certifikatës së pronësisë me nr. 224065;

c) Central elektrik, pasuri e paluajtshme sip. 4950 m<sup>2</sup>, certifikatë pasurie nr. 268960;

d) Central elektrik, pasuri e paluajtshme 3800 m<sup>2</sup>, certifikatë pasurie nr. 268962.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

VENDIM  
Nr. 6, datë 13.1.2016

### PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS BILISHT

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit, operatorit sh.a. Ujësjiellës Bilisht, me:

Drejtues ligjor: Qirjako Argjir

Drejtues teknik: Qirjako Argjir

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Bilisht autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Bilisht.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare, deri në datën 12.1.2018.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Avni Dervishi

VENDIM  
Nr. 7, datë 13.1.2016

### PËR RINOVIM LICENCE UJËSJELLËS FSHAT LUSHNJË SHA

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e operatorit Ujësjiellësi Fshat Lushnjë sh.a., me:

Drejtues ligjor: Viktor Davidhi

Drejtues teknik: Rrapi Bica

2. Operatori Ujësjiellës Fshat Lushnjë sh.a., autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

3. Zona e shërbimit e këtij operatori është njësia administrative Bashkia Lushnjë, Fier, Shegan, Allkaj, Krutje, Bubullim, Kolonjë; Bashkia Divjakë, Remas, Tërbuf; Bashkia Fier, Libofsh; Bashkia Ura Vajguore Poshnjë.



4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 1-vjeçare, deri në datën 12.1.2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
Nr. 8, datë 1.2.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 24, DATË 26.11.2014, “PËR  
LICENCIM SHA UJËSJELLËS-  
KANALIZIME ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

Në vendimin nr. 24, datë 26.11.2014, “Për licencim sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Elbasan”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Drejtues ligjor: Elsid Zyma

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Avni Dervishi

**VENDIM**  
Nr. 10, datë 10.2.2016

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM  
PUBLIK PËR SHOQËRINË UK DURRËS  
SHA**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë UK Durrës sh.a.:

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizim me ujë	Largim e përpunim i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	61 lekë/m <sup>3</sup>	37 lekë/m <sup>3</sup>
Konsumator publik	115 lekë/m <sup>3</sup>	54 lekë/m <sup>3</sup>
Ente private	125 lekë/m <sup>3</sup>	56 lekë/m <sup>3</sup>

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar	100 lekë/muaj/klient
Konsumator publik	100 lekë/muaj/klient
Ente private	100 lekë/muaj/klient

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2016:

- uji pa të ardhura (humbjet)	60%
- niveli i matjes	89,2%
- kohëzgjatja e furnizimi	8 orë/ditë
- eficientia e energjisë	
- uji i pijshëm	1.3 kwh/m <sup>3</sup>
- kanalizime	0.8 kwh/m <sup>3</sup>
- ITUN	1.1 kwh/m <sup>3</sup>
- eficientia e stafit	4.5

p/000/lidhje

- mbulimi me ujë	85%
- mbulimi me kanalizime	46%
- norma e arkëtimit	90%
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standardeve	

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Durrës sh.a. do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi i KKRR-së nr. 36 datë 19.12.2011, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Durrës”, si dhe vendimi i KKRR-së nr. 24. datë 3.6.2013, “Për disa ndryshime në vendimin e KKRR-së nr. 36. datë 19.12.2011, “Për miratimin e tarifave për konsum publik për sh.a. UK Durrës dhe për shfuqizimin e vendimit të KKRR-së nr. 24, datë 1.10.2012, “Për miratimin e tarifës së shërbimit për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura për sh.a. UK Durrës”, shfuqizohen.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2016 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI  
Avni Dervishi